



**VENDIM**

**Nr.115 Datë 28.12.2010**

**PËR  
HEQJEN E STATUSIT TË KLIENTIT TË KUALIFIKUAR  
SHOQERISE “ANTEA CEMENT SH.A DHE RIKTHIMIN NË  
STATUSIN E KLIENTIT TARIFOR PO KËSAJ SHOQËRIE PËR  
OBJEKTIN FABRIKA E ÇIMENTOS PRANË BORIZANËS KRUIJË**

Në mbështetje të neneve 9, dhe 48, të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, dhe nenit 7, gërma “a” dhe 8 të “Rregullores për kriteret e dhënies dhe heqjes së statusit të klientit të kualifikuar”, miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.99, datë 27.12.2006, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 28.12.2010, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Antea Cement” sh.a, për heqjen e statusit të klientit të kualifikuar dhe rikthimin në statusin e Klientit Tarifor për objektin Fabrika e Çimentos pranë Borizanës, Krujë,

**Konstatohet se :**

Aplikimi plotëson kërkesat e Rregullores për kriteret e dhënies dhe heqjes së statusit të Klientit të Kualifikuar dhe Vendimit nr.8, datë 29.01.2010 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s ”Per miratimin e nivelit te konsumit vjetor të energjisë elektrike për përfitimin e statusit të klientit të kualifikuar për vitin 2010.” Cez Shperndarja sh.a me shkresën nr. 8550/1, datë 17.12.2010, konfirmon se është e gatshme të furnizojë me energji elektrike duke filluar nga data 01.01.2011, shoqërinë “ANTEA Cement” sh.a nën skemën e çmimeve të rregulluara të miratuar nga ERE për vitin 2011.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

**Vendosi:**

1. Ti heqë statusin e Klientit të Kualifikuar shoqërisë “ANTEA CEMENT sh.a” dhe rikthimin e saj në statusin e Klientit Tarifor për objektin fabrika e çimentos pranë Borizanës Krujë.
2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së konsumatorit të njoftojnë aplikuesin për Vendimin e Bordit te Komisionereve te ERE-s.

Ky vendim hyn ne fuqi menjehere.

Ky vendim botohet ne Fletoren Zyrtare.